




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-3914/15
Dep.		Prot. No.	
Nr.faq.	02	Data	05.11.2015
Broj. stranica		Datum	
Nr. pages		Dat.	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.11.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2932 -15 për z.Zenel Shatri –Anëtar i Kuvendit komunal-Istog, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z.Shatri ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në një biznes privat, duke shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2932-15, për Zyrtarin e lartë, z. Zenel Shatri – Anëtar i Kuvendit Komunal në Istog, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Shatri është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (ZD/DPK-01-3738/15), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Shatri, është deklaruar se do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell një shkresë përcjellëse (njoftim) si dhe shkresën zyrtare nga Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin"(DPK/DPKI-03-02-3738/15), në të cilën shihet se z.Shatri tashmë ka heq dorë nga ushtrimi i funksionit të personit të autorizuar në biznesin: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

“Medica-Z” Sh.p.k. , me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

